

**LIGJI Nr. 04/L-008
PËR KËSHILLIN EKONOMIKO-SOCIAL**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR KËSHILLIN EKONOMIKO-SOCIAL

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj rregullon dhe përcakton organizimin, fushëveprimin, format e punës dhe funksionimin e përgjithshëm të Këshillit ekonomiko-social, si dhe përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përfaqësimin e partnerëve social në këtë organ trepalësh.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjithë partnerët social në nivel nacional, të cilët në KES-ë përfaqësohen nga:

- 1.1. Organizatat e të punësuarve (sindikatat);
- 1.2. Organizatat e punëdhënësve; dhe
- 1.3. Qeveria e Kosovës.

**Neni 3
Qëllimi i themelimit të Këshillit Ekonomiko-Social**

Këshilli Ekonomiko-Social (KES), themelohet me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të dialogut social në Republikën e Kosovës për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësisë së veçantë, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale, që realizohen, përmes zgjidhjeve të kontesteve me marrëveshje dypalëshe apo trepalëshe.

**Neni 4
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Partnerë social** - përfaqësuesit e organizatave të punësuarve (sindikatat), përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe autoritetet qeveritare të Republikës së Kosovës;
- 1.2. **Dialogu socio-ekonomik** - procesi demokratik i konsultimeve dhe i këmbimit të informatave në mes të përfaqësuesve të punëdhënësve, të punësuarve dhe të Qeverisë;

1.3. **Organizatat e të punësuarve** - (sindikatat) - organizata të pavarura, vullnetare të të punësuarve, të themeluara për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve;

1.4. **Organizatat e punëdhënësve** - organizata në të cilat punëdhënësit bashkohen vullnetarisht, për mbrojtjen e interesave të tyre;

1.5. **Organet profesionale të KES-it** - organe të Këshillit Ekonomiko-Social, të cilat zgjedhën me qëllim të shqyrtimit dhe përmbartimit të çështjeve të caktuara nga fusha e dialogut social;

1.6. **Sekretariati** - organi i Këshillit ekonomiko-social, i cili e ndihmon KES-in në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tij, përmes kryerjes së punëve organizative, administrative, operative dhe teknike;

1.7. **Ministria** - Ministria përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale;

1.8. **KES-i** - Këshilli Ekonomiko-Social;

1.9. **OJQ** - Organizatë Jo-Qeveritare.

Neni 5 Këshilli Ekonomiko-Social

1. Këshilli Ekonomiko-Social (në tekstin e mëtutjeshëm "KES"), është organ i nivelit nacional, i cili udhëheq konsultimet dhe bënë propozime organeve kompetente për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikën ekonomike në Republikën e Kosovës.

2. KES-i si organ më i lartë trepalësh është apolitik dhe funksionon si i pavarur, pa ndikim të ndonjë grupacioni apo interesi politik që vjen nga jashtë.

Neni 6 Përbërja e Këshillit Ekonomiko-Social

1. KES-i përbëhet prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve, të cilët në këtë organ përfaqësojnë interesat e Organizatave të punësuarve, Organizatave të punëdhënësve dhe Qeverisë.

2. KES-i përbëhet nga:

2.1. pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Organizatat e të punësuarve;

2.2. pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Organizatat e punëdhënësve; dhe

2.3. pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Qeveria e Kosovës.

3. Përfaqësimi në KES i Organizatave të të punësuarve dhe Organizatave të punëdhënësve, përcaktohet në përputhje me kushtet dhe kriteret e parapara në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 7 Kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES

1. Kushtet dhe kriteret për përfaqësimin në KES, për Organizatat e të punësuarve, janë:

1.1. numri i përgjithshëm i anëtarëve, i vërtetuar përmes dëshmisë (deklaratave personale, librezës së anëtarësisë, etj.) dhe pagesës së anëtarësisë sindikale, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10%, nga numri i tërësishëm i të punësuarve në Republikën e Kosovës;

- 1.2. numri i marrëveshjeve kolektive të lidhura me ndërmarrjet apo institucionet e ndryshme;
- 1.3. numri i degëve sindikale, të anëtarësuara në format e organizimit sindikal në nivel nacional, të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES-ë;
- 1.4. numri i zgjidhjes së kontesteve të punës dhe kontesteve të tjera përmes marrëveshjeve kolektive dhe ndërmjetësimit;
- 1.5. anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të punëtorëve.

2 . Kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES-ë për Organizatat e punëdhënësve janë:

- 2.1. numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të anëtarësuara, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Administratën Tatimore të Republikës së Kosovës;
- 2.2. numri i punëtorëve të punësuar në ndërmarrjet e anëtarësuara në Organizatat e punëdhënësve të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES-ë;
- 2.3. numri i zgjidhjes së kontesteve të punës dhe kontesteve tjera, përmes marrëveshjeve kolektive dhe ndërmjetësimit;
- 2.4. numri i ndërmarrjeve dhe subjekteve tjera ekonomike të cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë në nxitjen e punësimit dhe zbutjen e papunësisë;
- 2.5. anëtarësimi në Organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve.

3. Institucionet e Republikës së Kosovës, në Këshillin Ekonomiko-Social, përfaqësohen nga ministrat e këtyre ministrive:

- 3.1. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 3.2. Ministri i Financave;
- 3.3. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
- 3.4. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe
- 3.5. Ministri i Shëndetësisë.

4. Ministria do të shpall ftesë publike për përfaqësimin në KES-ë, për organizatat e të punësuarve dhe organizatat e punëdhënësve të nivelit nacional, që veprojnë dhe punojnë në Republikën e Kosovës.

5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr akt nënligjor për përbërjen e komisionit përzgjedhës për anëtarët e KES-it, nga organizatat e të punësuarve dhe të punëdhënësve.

Neni 8 **Funksionet e KES-it**

1. Funksionet e Këshillit Ekonomiko-Social janë:

- 1.1. këshillimi dhe udhëzimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, në krijimin dhe realizimin e politikave të punës, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike;

1.2. nxitja e konsultimeve në mes palëve, si dhe nënshkrimi i kontratave dhe marrëveshjeve kolektive, në nivel nacional;

1.3. aktivitete të tjera të dialogimit ekonomiko-social, për zhvillimin dhe avancimin e politikave të punës dhe mirëqenies sociale në Republikën e Kosovës.

Neni 9

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e KES-it

1. KES-i me qëllim të realizimit të suksesshëm të funksioneve të tij, është përgjegjës dhe kompetent, për:

1.1. krijimin, zhvillimin dhe përparimin e dialogut social në Republikën e Kosovës;

1.2. nismat ligjore për nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga fusha e punës dhe punësimit, mbrojtjes sociale dhe politikave ekonomike në përgjithësi;

1.3. shqyrtimin dhe vlerësimin e politikave sociale si dhe ndërmarrjen e masave për krijimin e qëndrueshmërisë sociale në Republikën e Kosovës;

1.4. nxitjen e ideve për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve sociale në Kosovë;

1.5. politikat e nxitjes së punësimit, zbutjen e papunësisë, konkurrencën, produktivitetin e punës, çmimet, pagat dhe pagën minimale të të punësuarave në Republikën e Kosovës;

1.6. shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes sociale, me qëllim të ofrimit të rekomandimeve për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës;

1.7. sigurimin e vlerësimeve dhe opinionëve për organet përgjegjëse lidhur me zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes sociale;

1.8. vlerësimin e funksionimit të këshillave të punës në ndërmarrjet e sektorit privat, publik dhe format e tjera të organizimit statusor të ndërmarrjeve;

1.9. ofrimin dhe sigurimin e rekomandimeve për parandalimin dhe eliminimin e tregut informal të punës në Republikën e Kosovës;

1.10. si dhe për çështje të tjera të cilat mund të zgjidhen përmes dialogut socio- ekonomik.

Neni 10

Vlerësimet dhe rekomandimet e KES-it

1. KES-i shqyrton projektligje, akte nënligjore dhe dokumente të tjera politike dhe strategjike, të cilat janë të rëndësishme për pozitën socio-materiale të të punësuarve dhe punëdhënësve.

2. Vlerësimet dhe rekomandimet lidhur me dokumentin e shqyrtuar, nga paragrafi 1. i këtij neni, i paraqiten Ministrisë përkatëse e cila është përgjegjëse për çështjen e shqyrtuar në KES-ë.

3. Ministria përkatëse është e detyruar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes së vlerësimit-rekomandimit, ta informojë KES-in për qëndrimin e saj, lidhur me çështjen në fjalë.

4. Në rastet kur vlerësimet-rekomandimet janë të papranueshme për Ministrinë përkatëse, KES-i mund t'ia paraqesë Qeverisë së Kosovës, vlerësimin-rekomandimin lidhur me çështjen në fjalë.

Neni 11

Organet e KES-it

1. Për zhvillimin dhe avancimin e dialogut socio-ekonomik në Republikën e Kosovës, KES-i themelon organet e veta.

2. Organet e KES-it janë:

- 2.1. komisionet profesionale të KES-it;
- 2.2. grupet negociuese ad-hoc;
- 2.3. sekretariati i KES-it.

Neni 12

Komisionet profesionale trepalëshe

1. Në kuadër të KES-it, themelohen dhe funksionojnë këto komisione të përhershme profesionale trepalëshe:

- 1.1. Komisioni për legjislacion;
- 1.2. Komisioni për punësim dhe aftësim profesional;
- 1.3. Komisioni për paga, çmime dhe pensione;
- 1.4. Komisioni për mbrojtjen shëndetësore, të ambientit dhe sigurisë në punë për të punësuarit;
- 1.5. Komisioni për financa, ekonomi dhe privatizim;
- 1.6. Komisione apo grupe punuese ad-hoc, dhe
- 1.7. Komisione të tjera profesionale për shqyrtimin e çështjeve të cilat janë kompetencë e KES-it.

2. Komisionet profesionale trepalëshe, themelohen për të shqyrtuar dhe ofruar rekomandime për çështje të cilat janë kompetencë e tyre në takimet e KES-it dhe organeve tjera qeveritare, me qëllim të orientimit dhe zbatimit të politikave shtetërore në fushat të cilat i mbulojnë.

3. Për arritjen e objektivave, çdo komision mund të angazhojë profesionistë të kualifikuar të fushës për të cilën është kompetent.

4. Përbërja e komisioneve përcaktohet nga KES-i, dhe kjo përbërje nuk mund të ketë më shumë se nëntë (9) anëtarë.

5. Takimet e komisioneve, kryesohen nga kryesuesi i komisionit.

6. Kryesuesi i Komisionit caktohet nga KES-i, ndërsa anëtarët caktohen nga udhëheqësit e tyre.

7. Rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren për punën e KES-it, aplikohen edhe në punën e komisioneve dhe grupeve negociatore ad-hoc.

Neni 13
Grupet negociatore ad-hoc

1. Për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme nga puna, mirëqenia sociale dhe çështjet ekonomike, përfaqësuesit e Këshillit Ekonomiko-Social formojnë grupe negociatore ad-hoc.
2. Grupet negociatore ad-hoc të themeluara në KES-ë, përbëhen nga secila palë e përfaqësuar në KES-ë.
3. Grupet negociatore ad-hoc janë përgjegjëse për përpilimin e rekomandimeve përfundimtare për KES-in, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me negociatat nën mandatin e tyre.
4. Grupet negociatore ad-hoc i kryeson përfaqësuesi i autorizuar nga KES-i.

Neni 14
Sekretariati i KES-it

1. Për funksionimin efikas dhe të ligjshëm të KES-it themelohet dhe funksionon sekretariati i KES-it, si organ administrativ profesional.
2. Sekretariati i KES-it, duhet të ketë zyrën e vet me inventarin e nevojshëm për funksionimin normal të këtij organi.
3. Sekretariati përbëhet nga tre (3) zyrtarë, të cilët janë të zgjedhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Organizatat e të punësuarve (sindikatat) dhe Organizatat e punëdhënësve.
4. Përfaqësimi në sekretariatit të KES-it, do të jetë konform forcës prezantuese në KES-ë.
5. Sekretariati i KES-it është përgjegjës për kryerjen e punëve profesionale, administrative, teknike dhe operative për Këshillin Ekonomiko-Social si dhe organet të cilat i zgjedh KES-i.
6. Punën e Sekretariatit e drejton udhëheqësi i sekretariatit, i cili për punën e vet dhe të sekretariatit i përgjigjet dhe i raporton kryesuesit të KES-it
7. Për përmbartimin e suksesshëm të funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të KES-it, të përcaktuara në nenin 8 dhe 9 të këtij ligji, sekretariati duhet të bashkëpunojë me të gjitha strukturat organizative të KES-it, si dhe me organizma tjerë me interes.

Neni 15
Burimet financiare për punën e KES-it

1. Buxheti për fushëveprimin e KES-it, përbëhet nga:
 - 1.1. mjetet financiare të buxhetit të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. kontributet vullnetare të Organizatave të punëdhënësve dhe të punësuarve; dhe
 - 1.3. donacionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.
2. Mjetet nga buxheti i Republikës së Kosovës, do të përdorën për mbulimin e shpenzimeve për të gjitha aktivitetet e KES-it.

3. Mjetet financiare të grumbulluara nga kontributet e Organizatave të punëdhënësve dhe të punësuarve do të përdoren për financimin e seminareve, vizitave studimore, organizimin e konferencave dhe për çështjet e tjera të cilat janë me interes për organizatat e lartpërmendura.

4. Në afatin ligjor KES-i bën propozimin dhe miratimin paraprak të projektbuxhetit vjetor, dhe nëpërmjet Ministrisë ia propozon atë për miratim Qeverisë së Kosovës.

5. Për angazhimin, kontributin dhe punën efikase të KES-it, anëtarët e KES-it kanë të drejtë në kompensim mujor.

5.1. ky kompensim është 10% nga paga mujore (bruto), e ministrave në Qeverinë e Republikës së Kosovës;

5.2. kompensimi mujor nuk i takon anëtarit të KES-it, atëherë kur ai nuk merr pjesë në një takim të KES-it.

6. Për angazhimin, kontributin dhe punën efikase të komisioneve të përhershme profesionale, anëtarët e komisioneve, kanë të drejtë në kompensim mujor.

6.1. ky kompensim është 10% nga paga mujore bruto të sekretarit të përhershëm të ministrive në Qeverinë e Republikës së Kosovës;

6.2. kompensimi mujor nuk i takon anëtarit të komisioneve të përhershme profesionale, atëherë kur ai nuk është i pranishëm, së paku, në dy (2) takime të caktuara nga komisionet e përhershme profesionale.

7. Anëtarët e grupeve punuese dhe grupeve negociatore ad-hoc për angazhimet e tyre në këto grupe mund të kompensohen me vendim të veçantë të KES-it.

8. Shuma mujore e kontributeve për organizatat e punëdhënësve dhe të punësuarve, që duhet të paguajnë për KES-in, do të përcaktohet me akt të veçantë të nxjerrë nga KES-i.

Neni 16

Mënyra e punës në KES-ë

1. Takimet e KES-it janë të hapura dhe udhëhiqen nga kryesuesi i KES-it. Në mungesë të tij atë e zëvendëson zëvendësi i tij.

2. Kryesuesi i KES-it e përfaqëson këtë organ, lidhë punë juridike, nënshkruan akte, marrëveshje dhe kontrata, menaxhon me mjete financiare të KES-it, si dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së KES-it.

3. Funkcionin e Kryesuesit të KES-it, me rrotacion do ta ushtrojnë, përfaqësuesit e Republikës së Kosovës, përfaqësuesit e organizatave të punësuarve (sindikatave), dhe përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve.

4. KES-i për punën e vet dhe qëndrimet e marra lidhur me çështjet e caktuara, për të cilat paraqet vlerësime apo rekomandime mund ti informojë publikun, përmes mjeteve të informimit.

5. Format e punës për këtë organ, në mënyrë të detajizuar do të rregullohen dhe përcaktohen me rregulloren për punën të KES-it.

Neni 17

Marrja e vendimeve në KES

1. Vendimet e KES –it miratohen me 2/3 e votave të anëtarëve të përhershëm të KES- it.

2. Në takimet e veta KES-i mund të ftojë OJQ-ë të ndryshme dhe persona të respektuar (shkencëtarë, ekspertë, profesionistë dhe analistë), për zgjidhjen dhe vendosjen e ndonjë çështjeje të rëndësishme, të cilët nuk kanë të drejtë vote.
3. Të gjithë anëtarët e përfaqësuar në KES-ë kanë të drejtën e një vote.
4. Gjatë votimeve, anëtarët e përhershëm votojnë me votim të fshehtë, ndërsa kryesuesi i njofton me rezultatet e votimit në takimi.
5. Kryesuesi i KES-it, mund të vendosë që të gjithë partnerët social të votojnë me votim të hapur, kur kanë të bëjnë me çështjet procedurale dhe teknike.

Neni 18 **Organizimi i takimeve**

1. Këshilli Ekonomiko-Social i mban takimet e veta të rregullta, së paku një herë në muaj.
2. Për shqyrtimin e çështjeve emergjente të dialogut social, të cilat janë të rëndësishme së veçantë, për partnerët social, KES-i mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme.
3. Takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme thirren nga kryesuesi i KES-it.

Neni 19 **Udhëheqja**

1. Mbledhjet e KES-it udhëhiqen nga kryesuesi, i cili do të zgjidhet në përputhje me dispozitat e paragrafit 3. të nenit 17 të këtij ligji.
2. Kryesuesi i KES-it në vitin e parë pas miratimit të këtij ligji dhe themelimit të këtij organi do të jetë përfaqësuesi i Qeverisë, përkatësisht Ministri i Ministrisë përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale, i cili pasohet në mënyrë rotative nga përfaqësuesi i punëdhënësve dhe nga përfaqësuesi i të punësuarve.
3. Mandati i Kryesuesit të KES-it zgjat një (1) vit.

Neni 20 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të KES-it janë:
 - 1.1. të drejtojnë takimet e KES-it, sipas dispozitave të këtij ligji, Rregullores për punën e KES-it dhe akteve tjera nënligjore;
 - 1.2. të propozojë rendin e ditës dhe konkluzionet nga takimet e KES-it;
 - 1.3. të informojë Qeverinë, përmes Ministrit të Ministrisë përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale për rekomandimet e KES-it, si dhe për mendimet dhe qëndrimet e organizatave të të punësuarve dhe punëdhënësve;
 - 1.4. të përgatisë raport vjetor për punën e KES-it, si dhe
 - 1.5. detyra të tjera të përcaktuara me Rregulloren për zhvillimin e punimeve të KES-it dhe me akte tjera nënligjore.

Neni 21 **Emërimet dhe shkarkimet në KES-ë**

1. Secili partner social emëron përfaqësuesit e vet në KES-ë, sipas rregullave për zgjedhje dhe emërimi.
2. Mandati i anëtarëve të KES-it zgjat katër (4) vjet, të cilët po ashtu mund të riemërohen.
3. Mandati i anëtarëve të KES-it ndërpritet me
 - 3.1. dorëheqje;
 - 3.2. skadimin e afatit për emërimin e tij;
 - 3.3. nëse është dënuar së paku me gjashtë (6) muaj burgim;
 - 3.4. me shkarkim;
 - 3.5. për shkaqe shëndetësore; dhe
 - 3.6. në rast vdekje.

Neni 22 Zbatimi i Ligjit

Me propozimin e kryesuesit të KES-it, për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, në afatin prej gjashtë (6) muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, sekretariati i KES-it është i detyruar t'i përgatitë aktet e nevojshme nënligjore, të cilat në takimet e veta do t'i shqyrtojë dhe miratojë ky organ.

Neni 23 Shfuqizimi i legjislacionit të aplikueshëm

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ për themelimin e këshillit konsultativ trepalësh dhe dispozitat e Vendimit nr. 09/57 të datës 13.03.2009, të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore e cila është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 24 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-008
21 korrik 2011**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-010-2011, datë 03.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**